

## ISO 14000



Standardet e serisë ISO 14000 janë standardet më të njohura ndër standardet e tjera të ISO-s. Standardet e serisë **ISO 14000 janë zbatuar nga një numër shumë i madh organizatash e kompanish në mbarë botën, i cili dallohet mbi të gjitha për mundësitë që jep për të bërë sado pak të afta organizatat/kompanitë të përballen dhe të kapërcejnë sfidat e mjedisit.**

Standardet e familjes **ISO 14000** kujdesen kryesisht për "**menaxhimin e mjedisit**". Ato kërkojnë nga organizatat/kompanitë të:

- minimizojnë e efektet e rrezikshme në mjedis të shkaktuara nga aktiviteti i saj/tij, dhe
- arrijnë përmirësim të vazhdueshëm të performancës së saj/tij lidhur me mjedisin.

Pjesa më e madhe e standardeve të ISO-s janë tepër të specifikuar për një produkt të veçantë, material ose proces. Megjithatë, standardet si ISO 9000, ISO 14000 etj. Që kanë fituar një reputacion shumë të madh në nivel ndërkombëtar njihen edhe si "standardet universale të menaxhimit të sistemit".

- "**Universale**" në këtë rast do të thotë që i njëjti standard mund të aplikohet në:

- çdo organizatë/kompani e madhe apo e vogël qoftë, pavarësisht nga llojshmëria e produktit që nxjerr;
- pavarësisht nëse "produkti" është shërbim;
- në të gjithë apo në çdo sektor të aktivitetit, dhe
- pavarësisht nëse është një ndërmarrje/kompani private, organizatë jo-qeveritare apo një departament shtetëror.

"**Universal**" gjithashtu do të thotë që pavarësisht nga fusha/qëllimi i aktivitetit dhe madhësia e organizatës/kompanisë, nëse ekziston dëshira për të ngritur dhe zbatuar një sistem për menaxhimin e mjedisit, përfitimet nga një sistem i tillë shprehen nga një numër karakteristikash esenciale për secilin nga standardet e familjes ISO 14000 që sigurojnë këto kërkesa.

- "**Sistemi i menaxhimit**" fokusohet në strukturën e organizatës për menaxhimin e proceseve – ose aktivitetëve të saj – që transformojnë inputet në një produkt apo shërbim, i cili përmbush objektivat e organizatës, të tilla si plotësimi i kërkesave të klientëve për cilësinë, zbatimi i legjislacionit në fuqi apo plotësimi i objektivave lidhur me mjedisin.

Standardet e familjes ISO 14000 i gjeni në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (DPS) të përkthyer në shqip.

**Standardet kryesore:**

**S SH EN ISO 14001** - Sistemet e menaxhimit mjedisor - Specifikime me udhëzim për përdorim.

**S SH ISO 14004** - Sistemet e mnaxhimit të mjedisit - Udhëzues të përgjithshëm për parimet, sistemet dhe teknikat për zbatimin e tyre.

**Çmimet për standardet kryesore të familjes ISO 14000 janë:**

Për Bashkëpunëtor

S SH EN ISO 14001 – 25 faqe – 1785 lekë

S SH ISO 14004 – 41 faqe – 3248 lekë

Për Jobashkëpunëtor

S SH EN ISO 14001 – 25 faqe – 3570 lekë

S SH ISO 14004 – 41 faqe – 4641 lekë

***Na kontaktoni:***

Rruga "Mine Peza", Nr.143/3,  
1014 - Tiranë, Shqipëri  
Kutia Postare 98  
Tel: (04) 22 62 55; (04) 24 71 75  
Fax: (04) 24 71 77  
E-mail: info@dps.gov.al

Përgatiti  
Kostanca Dedja  
DPS